

MARREVESHJE

PER:BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE SHOQERIVE

“GLOBAL EDGE RESEARCH” SH.P.K DHE “GLOBAL MARKETING CONNECTIONS” SH.P.K

Tirane,me 02.11.2018

- **Shoqeria:** “GLOBAL EDGE RESEARCH” SH.P.K , eshte regjistruar si person juridik prane QKB-se me date 27.09.2017, me seli :Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga:Kavajes , Kompleksi Park Construction, kulla D , shkalla 2, kati ,2 Tirane

Shoqeria “GLOBAL EDGE RESEARCH” SH.P.K, me Nipt: L72127017Q, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 67.615 (Gjashtedhete e shtatemije e gjashteqind e pesembedhete) Leke e barazvlefshme me 500 (Euro), te perbere nga 1 kuote ,me kontribut ne masen 100% te ortakut te vetem Raymond William Fieldhouse.

Administratori i shoqerise eshte Benard Zifla

- **Shoqeria:** “GLOBAL MARKETING CONNECTIONS” SH.P.K , eshte regjistruar si person juridik prane QKB-se me date 09.01.2017, me seli:Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajes,Kompleksi Delijorgji,Kulla 2,Kati 2,Tirane

Shoqeria “GLOBAL MARKETING CONNECTIONS” SH.P.K, me Nipt: L71309026V, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 100.000 (Njeqindmije) Leke, te perbere nga 1 kuote ,me kontribut ne masen 100% te ortakut te vetem “Global Edge Research” shpk

Administratori i shoqerise eshte Raymond William Fieldhouse.

Pas bisedimeve paraprake,organet vendimarrrese te te dy shoqerive kane rene dakort per bashkimin e shoqerive, ne zbatim te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Neni 215,pika 1.

Ne zbatim te Nenit.216,pika 1 te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”,hartohet ky project per bashkimin e shoqerive me keto kushte:

1. **Bashkimi** do te kryhet ne formen e perthithjes, ku shoqeria “GLOBAL EDGE RESEARCH” SH.P.K, do te jete shoqeria perthithese dhe shoqeria “GLOBAL MARKETING CONNECTIONS” SH.P.K, do te jete shoqeria e perthithur.
2. **Raporti i kembimit te Kuotave** do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014, ne ndryshim te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”,Neni 68, pika 2, ku cdo ortak do te kete 1 kuote, ndersa pjesmarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do te jete mbi bazen e vleres ne leke qe ze shumta e kapitalit themeltar vte seciles shoqeri qe merr pjese ne procesin e perthithjes ndaj kapitalit

themeltar te shoqerise se re pas perthithjes e rrjedhimisht dhe secili ortak ne raport me pjesmarrjen ne kapitalin themeltar te shoqerise qe merr pjese ne procesin e perthithjes e me pas me raportin e secilit ortak ne kapitalin themeltar te shoqerise se re pas perthithjes.

3. **Kushtet e ndarjes se kuotave te shoqerise pas bashkimit me perthithje do te jete ne zbatim te Ligjit 129/2014 date 02.10.2014, ne ndryshim te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Neni 68, pika 2, ku cdo ortak do te kete 1 kuote, ndersa pjesmarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do te jete mbi bazen e raportit qe ze secili kapital themeltar i shoqerive te vecanta ndaj totalit te kapitalit themeltar ne shoqerine e re.**
4. **Data, duke nisur nga e cila zoteruesit e kuotave (ortaket e shoqerise se re pas perthithjes) kane te drejte te marrin pjese ne ndarjen e fitimit do te jete 01.01.2018**
5. **Data, duke nisur nga e cila veprimet e shoqerise "GLOBAL MARKETING CONNECTIONS" SH.P.K qe perthithet, do te trajtohen nga pikepamja kontabel si veprime te shoqerise perthithese "GLOBAL EDGE RESEARCH" SH.P.K, do te jete 01.01.2018**
6. **Te drejtat qe shoqeria perthithese "GLOBAL EDGE RESEARCH" SH.P.K u njeh zoteruesve te kuotave (ortakeve), jane ato qe percaktohen ne statutin e shoqerise perthithese "GLOBAL EDGE RESEARCH" SH.P.K dhe ne zbatim te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".**
7. **Perparesite apo kufizimet e Administratorit te shoqerise se re pas perthithjes do te jene ato qe i njeh statuti i shoqerise perthithese "GLOBAL EDGE RESEARCH" SH.P.K dhe ne zbatim te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".**
8. **Pasojat e bashkimit nuk do te kene asnje influence ndaj te punesuarve te te dyja shoqerive qe marrin pjese ne procesin e perthithjes.**
9. **Pasojat e bashkimit nuk do te kene asnje influence ndaj te treteve te seciles shoqeri para perthithjes.**
10. **Ortaku i shoqerise se re do te jete: Raymond William Fieldhouse.**
11. **Emri i shoqerise se krijuar nga bashkimi do te jete "GLOBAL EDGE RESEARCH" SH.P.K.**

12. **Selia e shoqerise se re do te jete: Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga: Kavajes , Kompleksi Park Construction, kulla D , shkalla 2, kati ,2 Tirane**

13. **Statuti i shoqerise se re pas perthithjes do te jete ai i shoqerise "GLOBAL EDGE RESEARCH" SH.P.K. para perthithjes.**

14. **Objekti i veprimtarise se shoqerise se re pas perthithjes do te jete si me poshte: Kryerja e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe /ose pjesemarrjen e cdo veprimtarie apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuara, e krijuar ne baze te ligjislacionit shqiptar, sic mund te ndryshohet here pas here. Aktiviteti i shoqerise do te konsistoje kryesisht ne kerkim/studim tregu, mbledhje, analizim, perditesim informacioni dhe te dhenash lidhur me tregun; shitjen dhe shperndarjen e informacionit te mbledhur dhe te perpunuar. Administrim e call center, krijimin, administrimin e databeseve. Shërbime promovimi, marketingu dhe ndërmjetesim tregtar. Aktivitet në fushën e marketingut, telemarketingut, dhe teleshitjes. Transmetimi i ofertave dhe shërbimeve nëpërmjet telefonit, kompjuterit dhe shtypit. Konceptimi, realizimi, transmetimi i ofertave dhe shërbimeve teleaudio (Auditex) dhe kurse te përgatitjes profesionale. Çdo veprim tregtar, industrial, financiar mobiluar dhe imobiluar në zbatimin e objektit të shoqërisë me përjashtim të aktiviteteve që nuk lejohen nga ligji**



15. Administratori i shoqerise se krijuar nga bashkimi do te jete Benard Zifla , me nje mandate 3(tre) vjecar.

16. Baza e nisjes per bashkimin do te jene treguesit e bilancit te dates 31.12.2017, ndersa aktiviteti i vitit 2018 do te jete i perbashket me sistemimet e nevojshme sipas Standarteve Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara ne zbatim te Ligjit Nr.9228, date 29.04.2004 “ Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

17. Kapitali aksioner dhe Perqindjet (te trajtuara ne piken 2 dhe 3 si me siper) e secilit ortak ne kapitalin e ri themeltar te krijuar nga bashkimi do te percaktohen pas paraqitjes se raportit nga Audituesi Ligjor Zj.Liri Gjoka, me License Nr.271, date 27.08.2012, te leshuar nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar (IEKA).

18. Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise “GLOBAL MARKETING CONNECTIONS” SH.P.K do ti kalojne shoqerise “GLOBAL EDGE RESEARCH” SH.P.K.

19. Shoqeria perthithese “GLOBAL EDGE RESEARCH” SH.P.K. dhe shoqeria e perthithur “GLOBAL MARKETING CONNECTIONS” SH.P.K me miratimin e Ortakeve me te drejte vote te shoqerive pjesmarrese ne bashkim ne zbatim te pikes 7, te nenit 216 te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, perjashtojne detyrimin per pasqyrat kontabel te permandura ne piken 5, si dhe njoftimit sipas pikes 6-te pot e nenit 216 te te Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

Per “GLOBAL EDGE RESEARCH” SH.P.K

Per “GLOBAL MARKETING CONNECTIONS” SH.P.K

Perfaqesuesi Ligjor

Perfaqesuesi Ligjor

Benard Zifla



Raymond William Fieldhouse

